



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 46 datë 27.9.2022**

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2022 E MIRATUAR ME “VKB NR 3,  
DATË 05.01.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE  
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2022-2024 TË  
BASHKISË SHKODËR” DHE DETAJIMIN E FONDIT TE ALOKUAR PER  
EMERGJENCAT CIVILE PER VITIN 2022**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimine procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” neni 3,3.1, gërmat a,b,dh, ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr.68/2017 ‘Për financat vendore’, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “mbi procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit’, i ndryshuar, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 10.01.2022 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, shkresës nr. 6937/1 datë 28.04.2022 të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit “Dërgohet miratimi për rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile, për vitin 2022”, shkresës nr.1007/1 prot, datë 17.06.2022 “Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022” të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, VKB nr. 06 datë 28.01.2021 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”, VKB nr. 01 datë 05.01.2022 “Për

miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”, VKB nr.12 datë 04.02.2022 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”, VKB nr.27 datë 10.05.2022 “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”, VKB nr 3, datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të bashkisë Shkodër”, i ndryshuar së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare, relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

## V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesën e planit të Emergjencave Civile për vitin 2022 të akorduara nga Ministria e Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë si Transferte e kushtezuar në programin 10910, kapitulli 01, artikulli 604, në shumën prej **29,695,583 lekë**.
2. Të miratojë detajimin e fondeve të kushtëzuara prej **29,695,583 lekë** të Emergjencave Civile për vitin 2022 si më poshtë:
  - a) Dhënie ndihmës financiare për vlerat ndërtimore dhe orendive për kompensimin në masën 50% të vlerës së dëmit në shumën **11,240,220 lekë** në aktivitetin P03280.O1.A2. “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie” ( Pr. 10910 kodi i Ministrisë ) të miratuara me VKB si më poshtë:
    - i. VKB nr. 06 datë 28.01.2021 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”,
    - ii. VKB nr. 01 datë 05.01.2022 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”,
    - iii. VKB nr.12 datë 04.02.2022 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare” ( me ndryshimet e bera në VKB nr 56 date 01.11.2021),
    - iv. VKB nr.27 datë 10.05.2022 “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare”

Detajimi i shumës 11 240 220 leke do jete sipas tabelës nr. 1 bashkelidhur projekt vendimit.

(Tabela nr. 1 – Llogaritja e kompensimit të 50% të vlerës ndërtimore dhe orendive)


- b) Ruajtjen e fondit gjëndje për përballimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri në masën 50% të vlerës së dëmit për raste të paparashikuara gjatë vitit 2022 si dhe për situata të paparashikuara për emergjencë civile gjatë vitit 2022 në shumën **7,455,363 lekë** në aktivitetin P03280.O1.A2. “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie” ( Pr. 10910 kodi i Ministrisë ).


c) Planifikimin e aktivitetit P03280.O1.A5 “Ndërhyrje Emergjente për rehabilitimin e segmentit Prekal- Ndërlysaj” ( Pr. 10910 kod i Ministrise ) në shumën **11,000,000** lekë sipas fishes bashkëlidhë projekt vendimit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.


4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
Brisela **KADJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
Denis Lesha

Miratuar me 37 vota

Vota Pro 37

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.9.2022

<p>Nr.5</p>	<p>P03280.O1.A 5</p> <p>Ndërhyrje Emergjente per rehabilitimin e segmentit Prekal -Ndërlytaj.</p>	<p>Funksioni 3: Rendi dhe siguria publike</p> <p>N/Funksioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri</p> <p>Llojet e programit: 03280:Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile</p>	
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>			
<p>i. Situata ( Shpjego në menyre të detajuar problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</p>			
<p>Bashkia e Shkodrës është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 dt. 17. 12. 2015, "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 23, Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 4: Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore. Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 915, datë 11.11.2015, "Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve", neni 1, ka kaluar në administrim të Bashkisë së Shkodrës fondin e rrugëve rurale ndër të cilat edhe rrugën e Dukagjinit.</p> <p><b>Problematika që paraqiten.</b></p> <p>Rruga Prekal-Kir-Mali i Shoshit-Breg Lumi-Ndërlytaj është në gjendje shumë të rënduar për arsye të terrenit shumë të vështirë malor, mungesës së investimeve dhe fondeve të pamjaftueshme të akorduara për mirëmbajtje nga transfeta specifike. Në këtë segment janë krijuar probleme që paraqesin rrezikshmëri për kalimtarët si rezultat i vërshimeve të rreshjeve që kanë krijuar gërryerje në trupin e rrugës duke zvogëluar seksionin e rrugës në shumë vende. Mungojnë tombinot që janë të domosdoshme si pasoje e vërshimeve të ujërave nga mali. Nevojitet ndërtimi i mureve mbajtëse për përforcimin e trupit të rrugës dhe shmangur rrezikun e shëmbjes në disa vende përgjatë segmentit.</p> <p>Me fondin e propozuar parashikohen ndërhyrjet emergjente për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punime germimi për zgjerimin e rruges;</li> <li>- Punime germimi per trupin e rruges;</li> <li>- Punime shtresash rrugore me cakull dhe stabilizant;</li> <li>- Punime për largimin e ujrave nga rruga në vendet që krijohen probleme nga vërshimet e rreshjeve me kanale kulluese si dhe vepra arti të vogla si tombino, portale hyrese/dalese etj.</li> <li>- Ndërtim i mureve mbajtëse me qëllim përforcimin e trupit të rruges për të shmangur rrezikun e shëmbjes së rrugës ne vende të caktuara nga cedimet dhe gërryerjet si rezultat i vërshimit të ujërave nga mali.</li> </ul> <p>Këtë segment e përshkojnë banorët e tre Njësi Administrative Shalë, Shosh dhe Pult si dhe vizitorët e shumtë që frekuentojnë këto zona. Ndërhyrja emergjente për rehabilitimin e këtij segmenti do të përmirësojë sigurisë gjatë qarkullimit të mjeteve që shërbejnë për banorët e zonës dhe vizitorëve të shumtë që frekuentojnë këto zona.</p>			
<p>ii. Synimi i projektit</p>			
<p>Për vitin 2022</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë;</li> <li>• Të përmirësojë rrjetin rrugor, nëpërmjet rehabilitimit dhe përmirësimit të rrugëve ekzistuese rurale. Të risë aksesin ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.</li> <li>• Të risë sigurinë e lëvizjes në rrugë të automjeteve;</li> </ul>			
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>			
<p>Për vitin 2022</p> <p>Parashikimi në buxhetin e Bashkisë për vitin 2022.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi dhe përcaktimi i prioriteteve të shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore;</li> <li>• Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve;</li> <li>• Përcaktimi i volumeve të punës;</li> <li>• Preventivi i punimeve do të hartohet me miratimin e fondit sipas nevojave prioritare gjatë gjithë segmenteve të rrugës.</li> </ul>			
<p>Nr</p>	<p>Nr. Analize</p>	<p>EMERTIM I PUNIMEVE</p>	<p>NJESIA</p>
<p>PUNIME GERMIMI</p>			
<p>1</p>	<p>3.89/a</p>	<p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet</p>	<p>m3</p>
<p>2</p>	<p>3.158/3a</p>	<p>Transport dheu me auto deri 3.0 km</p>	<p>m3</p>
<p>3</p>	<p>3.161/2</p>	<p>Rrafshim skarpate ne germim, eskavator 0.25m3</p>	<p>m3</p>
<p>4</p>	<p>An.164/1</p>	<p>Mbushje me çakull e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri</p>	<p>m3</p>



**Tabela nr. 1 – Llogaritja e kompensimit te 50% te vleres te nderitimore dhe orentive**

NR	Emri I familjes	Vendimi I Keshillit Bashkiak	Vlera nderitimore dhe e orentive ne total te miratuar me VKB	Kompensimi i 50% te vlerës nderitimore dhe orentive	Humbje jete	Demshpërblim për humbje jete
1	Zef Pendushi	VKB Nr.06 datë 28.01.2021	375,948	187,974		
2	Fehime Abdurrahmani		1,034,937	517,469	1	500,000
3	Alfred Caka		815,663	407,832		
4	Shijetën Caka		931,910	465,955		
5	Hazis Dashi		1,045,034	522,517		
6	Armando Lekaj	VKB Nr.:01 datë05.01.2022	752,386	376,193		
7	Dritan Lekaj		761,186	380,593		
8	Elez Lekaj		866,986	433,493		
9	Sheukije Bardhi		830,386	415,193		
10	Besnik Cekaj	VKB Nr.:12 datë 04.02.2022 ( me ndyshimet e bera ne VKB nr 56 date 01.11.2021)	2,450,671	1,225,336		
11	Kujtim Domnori		348,890	174,445		
12	Lorenc Deda		326,596	163,298		
13	Mirash Marku		1,273,054	636,527		
14	Nuh Dajja		618,628	309,314		
15	Nuri Hoxha		363,111	181,556		
16	Prele Zelna		396,545	198,273		
17	Ramazan Ujka		861,256	430,628		
18	Skënder Ndruka		393,799	196,900		
19	Loro Gocaj	VKB Nr.:27 datë 10.05.2022	2,211,392	1,105,696		
20	Martin Sokoli		1,691,573	845,787		
21	Sokol Dema		1,032,310	516,155		
22	Lilijana Bici		1,252,398	626,199		
23	Asri Kalaja		845,780	422,890		
	<b>SHUMA</b>			<b>10,740,220</b>		<b>500,000</b>

		PUNIME SHITESASH					
5	3.211	Shtrese cakulli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2				
6	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2				
		PUNIME BETONI E BETONARMEJE					
7	3.235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3				
8	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30	m3				
9	3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25	m3				
		PUNIME HEKUR BETONI					
10	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ë 10mm	ton				
11	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	ton				
		NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT					
12	3.323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3				
13	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3				
14	3.352	Mbushje me gur kave	m3				
15	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	m				
16	3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni	m				
17	An-8	Mbushje me cakell pas mureve	m3				
<ul style="list-style-type: none"> <li>Alokimi i fondeve, monitorimi i realizimit të shërbimeve sipas kalendarit të ndërhyrjeve dhe volumeve të punës të parashikuar;</li> <li>Administrim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfutuesve të synuar).</b>							
<b>Për vitin 2022</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit afatgjatë të rrjetit rrugor nepermjet shërbimeve të mirëmbajtjes.</li> <li>Rritjen e sigurisë rrugore. Zvogelim i kohës së udhëtimit dhe ulje e kostos së amortizimit të mjeteve;</li> <li>Përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhja e rrugëve rurale me rrugët nacionale, qendrat e fshatrave me rrugët nacionale dhe qendrat e fshatrave brenda njësisë administrative.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës.</li> <li>Spektori i Emergjencave Civile.</li> <li>Spektori i planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës.</li> <li>Njësitë administrative: Pult, Shosh, Shalë.</li> </ul>			Bashkia e Shkodrës				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</b>							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ndërhyrje emergjente per rehabilitimin e segmentit Prekal-Ndërlysay	11,000					11,000
	<b>Shuma 2022</b>	<b>11,000</b>					<b>11,000</b>
<b>Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Fillon gjatë vitit 2022 dhe përfundon më 31 dhjetori 2022.</b>		<b>g) Përgatitja dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, Spektori i Emergjencave civile.</b>					